**BASHKIA MIRDITË**

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**
**QERSHOR 2024**

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 04.06.2024 | Kërkesë për Informacion | 19.06.2024 | Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar bashkisë Mirditë, nëpërmjet postës elektronike datë 04.06.2024. bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju informojmë se:<br>1. ***A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 jeç) për periudhen janar -dhjetor 2023? Nese po, sa perqind te shumes totale te buxhetit zene keto zera? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tille?***<br><br>Bashkia Mirditë në buxhetin e vitit 2023, nuk ka patur një zë buxhetor të dedikuar për Rininë. Arsye kryesore është pamjaftueshmëria financiare nga të ardhurat e bashkisë, për të ndarë një zë buxhetor të tillë. Tek zërat buxhetorë për Arsim, Sport dhe Kulturë gjejmë të përfaqësuar të rinj që janë pjesë e eventeve sportive të ekipit të volejbollit, apo eventeve kulturore që organizohen.<br>2. ***Sa eshte numri total i punonjesve ne Bashkine tuaj (2023)? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, edhe sipas gjinise?*** | E plotë | Pa pagesë |

| Numri i punonjësve | Femra | Meshkuj | Me AK | Femra | Meshkuj | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 342 | 202 | 140 | 3 | 2 | 1 | |

***3.Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkise tuaj në vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, edhe sipas gjinise?***

| Numri i të rinjve (18-29) | Femra | Meshkuj | Me AK | Femra | Meshkuj | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | 15 | 4 | - | - | - | - |

| Numri i të rinjve (18-29)<br>që mbajnë pozicione vendimarrëse | Femra | Meshkuj | Me Aftësi të Kufizuara | Femra | Meshkuj | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 (Administrator) | - | 1 | - | - | - | - |

***4.Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë Mirditë në vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me të aftësi të kufizuara?, edhe sipas gjinisë***

***4.A ka Bashkia juaj politika rinore të zhvillura specifikisht për grup moshën 15-29 vjeç? Nëse po a mund të na dërgoni një kopje të tyre? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?***

Jo, bashkia Mirditë ende nuk ka të miratuar një politikë të mirëfilltë rinore edhe pse në planin social apo edhe atë të strehimit, janë të adresuara çeshtje që prekin këtë grup-moshë.

***5. A keni në institucionin tuaj struktura përgjegjëse për politikat rinore? Nëse po, cilat janë ato (psh. drejtori, sektore, specialistë, struktura përfaqësimi rinor politike etj) dhe prej sa kohësh janë funkionale?***

Bashkia Mirditë nuk ka një strukturë të dedikuar për rininë në organigramën e saj për vitin 2023. Në strukturën e vitit 2024, çështjet e rinisë mbulohen nga Sektori i Integrimit Evropian dhe Projekteve.

***6. A ka struktura rinore të ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar - dhjetor 2023. Nëse po, cilat janë ato?***

Po, prej Korrikut 2022 eshtë konstituar Këshilli Vendorë Rinorë Mirditë. Në Korrik 2024 do të hapim thirrjen për këshillin e ri.

***7. Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individe, etj)?***

Për ngritjen e Këshillit Vendorë Rinorë Mirditë është ndjekur nje proces i cili ka përfshirë të gjitha palët e interesuar. Në mungesë të organizatave rinore apo për të rinjt në territor bashkëpunimi ka qenë kryesisht me grupe informale të rinjsh që vijnë kryesisht nga gjimnazet.

***8. A keni nje plan veprimi per Keshillin Vendor Rinore (KVR)? Sa aktivitete jane organizuar nga KVR pergjatë 2023?***

Jo, bashkia nuk ka patur nje plan veprimi per Këshillin Vendore Rinore. Pergjat 2023 nuk kemi realizuar anje aktivitet te drejtuar nga KVR.

***9. Sa te rinj jane te perfshire ne KVR? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara, edhe sipas gjinise?***

| Femra | Meshkuj | Gjithsej | Me aftësi të kufizuar |
|---|---|---|---|
| 3 | 2 | 5 | 0 |

***10. A keni pasur ju forma te tjera të bashkëpunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore. etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?***

Nuk kemi patur forma të tjera të bashkëpunimit.

***11. Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat që perdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese?***

Në konsultimet me publikun, nuk është se është mbajtur një evidence e tillë.

***12.. Lutemi listoni mjetet e komunikimit qe perdor bashkia juaj dhe link perkatese te faqes se webit te bashkise (website) dhe rjetet sociale si Facebook dhe Instagram.***

- Faqja Website e Bashkisë Mirditë http://bashkiamirdite.gov.al/

-Facebook
https://www.facebook.com/mirditebashkia/?locale=sq_AL

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | -Instagram https://www.instagram.com/bashkiamirdite/<br>***13. Sa eshte numri total i perfituesve nga Skema e Ndihmes Ekonomike per vitin 2023? Sa prej tyre janë femra?***<br>*Numri i përfituesve nga Skema e Ndihmes Ekonomike për vitin 2023* është 681 familje + 20 raste t dhunes ne familje = 701 familje gjithsej.<br>***14. Sa eshte numri e te rinjve (15-29 jeç) perfitues nga Skema e Ndihmes Ekonomike pēr vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?***<br>Nuk e kemi si statistikë.<br>***15. Sa eshte numri total i perfituesve te Pageses se Aftesise se Kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?***<br>Numri i perfituesve të Pageses se Aftesise se Kufizuar për vitin 2023 është 764 gjithsej (256 femra dhe 508 meshkuj).<br>***16. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 jeç) perfitues te Pageses se Aftësise se Kufizuar pör vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?***<br>Numri i te rinjve (15-29 jeç) perfitues te Pageses se Aftësise se Kufizuar pör vitin 2023 është 62 gjithsej , (23 femra dhe 39 meshkuj).<br>***17. Sa eshte numri total i personave te cilat jane pjesë e Sherbimeve te Kujdesit Shoqeror për vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?***<br>Aktualisht nuk ofrojmë shërbime të kujdesit shoqëror, pasi nuk kemi qendra shërbimi si qendra rezidenciale apo ditore.<br>***18. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjeç) te cilat jane pjese e Sherbimeve te Kujdesit Shaqeror per vitin 2023?. Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?***<br>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin! | | |
| | | | | | | |